

KONTRATË DHURIMI AKSIONESH

Sot, më datë 06.11.2024, në ambjentet e shoqërisë IMMO – INVEST sh.a. , me Nipt J81729501Q, me adrese në Durres, S.Z.Xhafzotaj, rruga Durres - Shijak, Km7.

1. DHURUES:

Z.Michele Doka zoterues i 50% të aksioneve të shoqërisë me vlerë 2.750.000 Leke me 275 aksione në shoqëri, identifikuar me nr.personal ID J21002082D, i datelindjes 02.10.1992, madhor dhe me zotësi të plote juridike për të vepruar

(Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si 'Dhuruesi')

2. PRANUES I DHURIMIT:

Z.Davide Doka, lindur në Brescia - Itali, dhe banues në Durres - Shqipëri, identifikuar me nr.personal ID J70120080O, i datelindjes 20.01.1997, madhor dhe me zotësi të plote juridike për të vepruar.

(Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si 'Përfituesi i dhurimit').

Rrethanat e hartimit të aktit të dhurimit:

Personat e lartpërmendur u paraqitën me vullnetin e tyre të lirë, të plotë e të pavarur dhe deklaruan se kërkojnë hartimin e kësaj kontrate për dhurimin e aksioneve të shoqërisë. Pasi u verifikua identiteti i tyre dhe dokumentet e paraqitura, hartohet kjo kontratë, në bashkëpunim me palët, duke përcaktuar kushtet e mëposhtme:

Baza Ligjore

- Neni 761 e vijues të Kodit Civil
- Neni 73, pika 1, gërma “ç” (për kuotat e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar ose neni 117, pika 1, gërma “ç” (për aksionet e shoqërive aksionare/anonime) të Ligjit nr 9901, datë 14.08.2009 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar

3. MEQËNËSE

Shoqëria Aksionere IMMO – INVEST sh.a., regjistruar në Republikën e Shqipërisë me nipt J81729501Q, me adrese në Durres, S.Z.Xhafzotaj, rruga Durres - Shijak, Km7, me kapital 5.500.000,00 (pesemilion e pesëqindmijë) leke, me 550 aksione me pjesëmarrje:

Z.Michele Doka zoterues i 275 aksioneve me vlerë 2.750.000,00 Leke me 50% të kapitalit të shoqërisë.

Z.Davide Doka zoterues i 275 aksioneve me vlerë 2.750.000,00 Leke me 50% të kapitalit të shoqërisë.

Sipas vendimit të ortakeve të datës 06.11.2024, palët pranojnë dhe deklarojnë dhurimin e kuotave si më poshtë:


IMMO - INVEST
NIPT. J81729501Q

Z.Michele Doka zoterues i 275 akioneve me vlere 2.750.000,00 Leke me 50% te kapitalit te shoqerise, vendos ti dhuroje 275 akioneve me vlere 2.750.000,00 Leke me 50% te kapitalit te shoqerise ndaj z.Davide Doka.

PËR SA MË SIPËR, në përputhje me marrveshjen e përbashkët të palëve, palët bien dakord si më poshtë:

NENI 1 - DHURIMI I AKSIONEVE

Sipas parashikimeve të kësaj kontrate, Dhuruesi i dhuron Pranuesit të Dhurimit dhe Pranuesi i Dhurimit pranon nga Dhuruesi kuotat si ne piken 3 te kontrates.

NENI 2 - DEKLARIME E GARANCI

Dhuruesi deklaron e garanton se: (i) nënshkrimi, dorëzimi e zbatimi i kësaj kontrate është autorizuar rregullisht nga dhuruesi, (ii) Dhuruesi është pronar e zotërues i kapitalit të shoqërisë, konform te gjitha te dhenave te regjistruara ne regjistik tregtar te shoqerise. (iii) Dhuruesi ka nënshkruar e paguar rregullisht kuotat/aksionet e kësaj kontrate, (iv) Aksionet e transferueshme këtu nuk janë objekt i asnjë kontrate pengu ose ndonjë pretendimi tjetër ligjor të palëve të treta, (v) Kjo kontratë përbën detyrimin ligjor, të vlefshëm e detyrues dhe të zbatueshëm për Dhuruesin.

Pranuesi i Dhurimit deklaron dhe garanton se: (i) Pranuesi i dhurimit ka të drejtë të lidhë këtë kontratë dhe nuk ka ndonjë pengesë ligjore ose të ndonjë lloji tjetër për lidhjen e kësaj kontrate, e të nënshkruajë e të zbatojë këtë kontratë dhe detyrimet që rrjedhin prej saj, (ii) kjo kontratë është zbatuar sic duhet dhe përbën një detyrim ligjor të vlefshëm dhe detyrues për Pranuesin e Dhurimit.

Pra, pas nënshkrimit të kësaj kontrate, aksioneret e shoqërisë “IMMO – INVEST sh.a.” do të jenë:

Z.Davide Doka, lindur ne Brescia - Itali, dhe banues ne Durres - Shqiperi, identifikuar me nr.perosnal ID J701200800, i datelindjes 20.01.1997, **zoterues i 100% te kapitalit te shoqerise me vlere 5.500.000,00 Leke dhe me 550 Aksione.**

NENI 3 - TË NDRYSHME

Kjo kontratë e nënshkruar në 4 (katër) kopje në gjuhën Shqipe, përbën marrveshjen e plotë të palëve dhe të gjitha premtimet, deklaratimet, mirkuptimet, garancitë dhe marrveshjet në lidhje me çështjen objekt të kësaj kontrate, për secilën palë janë shprehur në këtë akt. Ndryshimet në kontratë nuk do të jenë të vlefshme me përjashtim të rastit kur në mënyrë reciproke bihet dakord mes palëve dhe konfirmohet nga një dokument i shkruar dhe i firmosur nga palët apo përfaqësuesit e tyre.



IMMO - INVEST
NIPT: J817295010

NENI 4 - LIGJI I ZBATUESHËM DHE MOSMARRVESHJET

Paqartësitë në lidhje me çështjet e kësaj kontrate të cilat nuk janë përcaktuar në këtë kontratë, do të zgjidhen në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, që do të jetë i zbatueshëm për këtë kontratë.

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve të kësaj kontrate në lidhje me këtë kontratë, që nuk do të zgjidhet në mirëkuptim midis tyre, do të jetë objekt i vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, që mund të apelohej në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

ANEKSET E KONTRATËS

Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Aneksa të Kontratës:

- Vendimi i Asamblesë së Ortakëve, datë 06.11.2024, bashkëlidhur;
- Ekstrakt i Regjistrisë Tregtare për Shoqërinë “IMMO – INVEST”sh.a.;

Dispozitat Përfundimtare

Kontrata e kalimit të të drejtave, u lexua në prani të palëve kontraktuese, të cilët deklarojnë se e kuptojnë përmbajtjen e saj dhe meqënëse ajo shpreh vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, njohin dhe kuptojnë efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht.

U verifikua identiteti i palëve kontraktuese nëpërmjet dokumentave të identitetit.

Në zbatim të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale“, do të ruhen e do të përpunohen të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme

Palet

z.Michele Doka

MICHELE DOKA

z.Davide Doka

DAVIDE DOKA

IMMO - INVEST
NIPT: J817295010
XHAFZOTAJ DURRES